



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 2.2.2023

Nr: 3

Ora: 14:00

V E N D I M

P Ë R

NJË SHITESË NË RREGULLOREN “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR”, E MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 5, DATË 20.11.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në tekstin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, e miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, pas pikës 2, të nenit 7, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo kandidat të propozuar nga partia politike apo për shtetasit që kanë shprehur interes për t’u emëruar kryesisht si anëtarë apo sekretarë të KZAZ-së.”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Data: 2.2.2023 Nr: 3
Ora: 14:00



“Për një shtesë në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, e miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator”

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar